



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 33

2003

Maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9045 datë 3.4.2003	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë për realizimin e programit të ristrukturimit teknik dhe menaxhues të KESH-sha dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar”.....	1065
Ligj nr.9048 datë 7.4.2003	Për trashëgiminë kulturore.....	1086
Dekret nr.3809 datë 8.5.2003	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	1100

L I G J
Nr.9045, datë 3.4.2003

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË ITALISË PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË RISTRUKTURIMIT TEKNIK DHE MENAXHUES TË KESH-SHA DHE FUQIZIMIN E SISTEMIT ELEKTRIK SHQIPTAR”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë për realizimin e programit të rristrukturimit teknik dhe menaxhues të KESH-sha dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3785, datë 22.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË RISTRUKTURIMIT TEKNIK E MENAXHUES TË KESH-IT DHE FUQIZIMIN E SISTEMIT ELEKTRIK SHQIPTAR

Ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Industrisë dhe Energjitikës, në vijim e emërtuar MIE, nga njëra anë

dhe Qeverisë së Republikës Italiane, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim, në vijim e emërtuar MPJ/DPBZH (MAE/DGCS), nga ana tjetër:

duke qënë se në marrëveshjet e komisionit të përbashkët të datës 6 gusht 1998 janë pranuar të kryhen ndërhyrje të ndryshme strukturore në ndihmë të sektorit elektrik;

duke konsideruar që në Memorandumin Teknik të Mirëkuptimit të datës 5 maj 2000, janë përshkruar linjat kryesore të ndërhyrjes në mbështetje të sektorit për financime në formën e kredisë ndihmë që arrijnë në vlerë përmbledhëse prej 30 milionë euro;

duke qënë se gjatë komisionit të përbashkët të datës 7 korrik 2000 është përforcuar vullneti reciprok për të ndërhyrë bashkërisht me programe të ndihmës strukturore në sektorin elektrik shqiptar;

duke marrë parasysh që Pala shqiptare, në shqyrtim të gjendjes së rëndë, të keqe teknike në të cilën ndodhet sektori elektrik i vendit, i ka kërkuar Palës italiane të përdorë në favor të sektorit, financime të mëtejshme prej 10 milionë euro të dhëna për programe të tjera;

duke marrë parasysh që Pala italiane ka pranuar kërkesën duke e shtuar disponueshmërinë financiare të kredisë ndihmë në 40 milionë euro;

duke konsideruar që për realizimin e ndërhyrjes është parapërgatitur bashkërisht një dokument i projektit, në të cilin janë identifikuar dhe artikuluar ndërhyrjet me investime në favor të sektorit elektrik dhe ndërhyrje për një ndihmë teknike në dobi të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, në vijim e emërtuar KESH;

duke marrë parasysh që në datën 5 dhjetor 2001 Komiteti Drejtues i Bashkëpunimit për Zhvillim, ka shprehur një mendim pozitiv për dhënien e një kredie ndihmë prej 41 528 041 03 euro për realizimin e ndërhyrjes: “Programi i rristurimit teknik e menaxhues të KESH-it dhe i fuqizimit të sistemit elektrik shqiptar”, në vijim e emërtuar “Programi”, duke miratuar edhe një financim falas prej 979 460 51 euro (dhe më vonë e ripërsëritur në mbledhjen e datës 11 shkurt 2002), e gjithë kjo në rast se të dy Palët bien dakord si vijon:

Neni 1

Qëllimi dhe pjesët e Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të rregullojë zotimet e ndërsjella të të dy Palëve për një zbatim të saktë të programit, me një vëmendje të veçantë tek mënyrat e vlerësimit dhe lidhjes së kontratave, si dhe për menaxhimin/përgjegjshmërinë/shpenzimin e fondeve të kredisë ndihmë dhe dhuratë.

Marrëveshja në fjalë është e përbërë nga 14 nene dhe 7 lidhjet e mëposhtme, që janë pjesë përbërëse e pandarë:

1. Përmbledhja e Programit
2. Kushtet e zbatimit
3. Burimet financiare
4. Mbikëqyrja dhe treguesit
5. Kuadri rregullues
6. PMU-ja për menaxhimin e Programit
7. Mënyrat e operimit dhe menaxhimit të kredisë ndihmë.

Neni 2

Objektivat e Programit

Programi propozon që, nëpërmjet përmirësimit të efikasitetit dhe të vazhdimësisë së shërbimit elektrik, të përmirësojë standardin e jetës së popullsisë dhe të rrisë mundësinë e furnizimit me energji elektrike për sistemin prodhues, me qëllim që të përkrahë zhvillimin e biznesit në vend, dhe si rrjedhojë rritjen e investimeve private.

Për arrijtjen e këtij objekti të përgjithshëm, Programi synon, që “të përkrahë rritja hap pas hapi e pavarësisë tekniko-financiare të KESH-it sipas kriterëve bashkëkohorë të menaxhimit, që lejojnë futjen dhe përfshirjen (integrimin) e sektorit elektrik shqiptar në tregun rajonal”.

Neni 3

Përshkrimi i Programit

Në përputhje me objektivat e nenit 2, Programi synon të arrijë rezultatet si më poshtë vijojnë, me një kohëzgjatje të parashikuar për 36 muaj:

- riorganizimi i KESH-it sipas kriterëve bashkëkohorë të menaxhimit;
- zgjidhja hap pas hapi e krizës financiare të KESH-it;
- përmirësimi i sigurisë së furnizimit me energji elektrike.

Kjo do të bëhet duke realizuar aktivitetet e mëposhtme (të ilustruara më hollësisht në lidhjen 1):

1. Në lidhje me riorganizimin e Kesh-it sipas kriterëve bashkëkohorë të menaxhimit:

Asistencë drejtimi dhe profesionale për drejtuesit e KESH-it dhe transferim i eksperiencës organizative “know-how” nëpërmjet një ndihmese teknike për divizionet e KESH-it në përputhje me skemën e riorganizimit të përcaktuar nga Qeveria shqiptare.

Shërbime inxhinierike për kontrollin e rrjetit të transmetimit (Qendra dispeçer).

Ndërtimi i zyrave të reja të KESH-it dhe rehabilitimi i atyre periferike, përfshirë pajisjen me makina për lëvizjen e personelit.

2. Në lidhje me përmirësimin hap pas hapi të krizës financiare të kesh-it:

- Plotësimi i sistemit të kompjuterizuar të faturimit;
- Sigurimi dhe instalimi i matësve të energjisë elektrike.

3. Në lidhje me përmirësimin e sigurisë së shërbimit elektrik:
- furnizimi i materialeve dhe makinave për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes;
 - ndërtimi i nënstacioneve të rinj Tirana 2 dhe Tirana qendër (i mbyllur);
 - plotësimi i nënstacionit Kashar;
 - fuqizimi i nënstacionit Pogradec;
 - fuqizimi i rrjetit të shpërndarjes së Durrësit dhe Pogradecit.

Neni 4

Institucionet e përfshira në realizimin e Programit

Institucionet e përfshira në realizimin e Programit janë si më poshtë:

Për Palën italiane:

a) MPJ/DPBZH-ja, që do të sigurojë burimet financiare falas dhe në formë kredie, në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin italian në fuqi, të treguara në mënyrë të përmblendhur në këtë Marrëveshje. MPJ/DPBZH-ja, në bashkëpunim me MIE-në, do të ketë gjithashtu detyrën e mbikëqyrjes së ecurisë së Programit dhe sa ai është në gjendje të arrijë rezultatet e paraqitura në pikën 3 të mësipërme. MPJ/DPBZH-ja do të veprojë nëpërmjet zyrave kompetente për kryerjen e detyrave të saj. Në veçanti, njësia teknike qendore e MPJ/DPBZH-së, që në vijim do të emërtohet NJTQ (UTC) do të sigurojë të gjitha funksionet e karakterit teknik në mbështetje të realizimit të Programit.

b) Mediocredito Centrale (MCC), që – sipas instruksioneve të MPJ/DPBZH-së dhe Ministrisë Italiane të Ekonomisë – do të nënshkruajë me Ministrinë Shqiptare të Financave një Marrëveshje financiare që do të rregullojë përdorimin e fondeve të kredisë ndihmë. Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje financiare, MCC-së do të kujdeset për miratimin e secilës kontratë për furnizimin e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, nëpërmjet të cilave do të realizohen aktivitetet e parashikuara në Program. Do të jetë gjithashtu kujdesi i MCC-së që të sigurojë pagimin e kontratave respektive ndaj organizmave realizues.

c) Ambasada/njësia teknike vendore (NJTQ) në Tiranë, që do të sigurojë të gjitha funksionet e natyrës teknike të nevojshme për një mbikëqyrje të saktë të mbarëvajtjes së aktivitetit. Në kuadrin e aktivitetit të saj institucional, ambasada/NJTQ-ja do të sigurojë gjithashtu kontaktet e nevojshme me palët pjesëmarrëse në Program, duke u kujdesur, ndërmjet të tjerave, dhe për marrjen e transmetimin e të gjithë dokumentacionit zyrtar.

Për Palën shqiptare:

a) MIE-ja, që do të sigurojë realizimin e detyrave që rrjedhin nga kjo Marrëveshje duke përfshirë, nëse është e nevojshme, strukturat e tjera qeveritare kompetente.

b) Ministria e Financave (MF), që do të nënshkruajë Marrëveshjen financiare me MCC-në dhe që do të kujdeset për mbajtjen e kontakteve të punës me MCC-në dhe Bankat agjente, sikurse është përcaktuar edhe në Marrëveshjen financiare.

c) PMU-ja pranë MIE-së, që do të sigurojë koordinimin e nevojshëm ndërmjet entit financues dhe institucione të ndryshme ose firmave pjesëmarrëse në realizimin e Programit, me detyrën e veçantë për të koordinuar të gjitha funksionet me natyrë teknike dhe drejtuese, të nevojshme për realizimin e Programit, sikurse është treguar në lidhjen 6.

d) KESH-i, që do të sigurojë të gjithë aktivitetin mbështetës të ndihmës teknike të nevojshme për realizimin e Programit, sikurse është treguar në lidhjen 6, duke ngritur në gjirin e saj një PIU të veçantë, për të ndjekur drejtimin teknik të secilës kontratë.

Neni 5

Burimet financiare dhe mënyrat e përdorimit të kredisë ndihmë

Burimet financiare të nevojshme për realizimin e Programit (të detajuara në lidhjen 3) janë si më poshtë:

1. Fondi kredi ndihmë prej 41 528 041,03 euro për realizimin e të gjitha veprimtarive të parashikuara në Program.
2. Fondi dhuratë prej 162 167,47 euro për të siguruar funksionimin e PMU-së.
3. Fondi dhuratë prej 817 293,04 euro për misionet e shkurtëra/të gjata të ekspertëve italianë të

ngarkuar për të ndihmuar PMU-në dhe për të mbikëqyrur ecurinë e Programit.

4. Fonde të KESH-it, prej 9 812 618,08 euro të barasvlefshme, për mbulimin e shpenzimeve të kostove vendore (punime ndërtimore, taksa, detyrime doganore etj.).

Kohëzgjatja dhe kushtet e kredisë ndihmë janë si më poshtë:

- kohëzgjatja e kredisë ndihmë 36 vjet
- periudha pa pagesë principali 18 vjet
- interesi 0.40%

Mbi bazën e procedurave në fuqi të MPJ/DPBZH-së, hapat kryesore për t'u ndjekur për përdorimin e fondeve të kredisë ndihmë janë si vijon:

a) Nënshkrimi i marrëveshjes në fjalë.

b) Nxjerrja nga ana e Ministrisë së Ekonomisë Italiane të një dekreti ministror që autorizon MCC-në për të negociuar dhe firmosur "Marrëveshjen financiare" me MF-në.

c) Miratimi nga ana e MPJ/DPBZH-së e planit të prokurimit, të përgatitur nga PMU-ja në bashkëpunim me KESH-in dhe transmetuar nga MIE-ja, sikurse edhe saktësohet në lidhjen 7, seksioni I.

d) Nënshkrimi i Marrëveshjes financiare nga MCC-ja dhe MF-ja.

e) Përgatitja e njoftimit të zhvillimit të garave, për secilin projekt të treguar në planin e prokurimit, sikurse saktësohet në lidhjen 7, seksioni II. Kjo fazë kërkon përgatitjen e dokumenteve të garave, kontrollin e përputhshmërisë nga ana e MPJ/DPBZH-së dhe, në rast se ka një vlerësim pozitiv nga ana e saj, bëhet publikimi i njoftimit të garës në Itali (me shpenzimet e MPJ/DPBZH) dhe në Shqipëri (me shpenzimet e MIE-së).

f) Vlerësimi dhe lidhja e çdo kontrate, për secilën nga garat e përfunduara, saktësohet në lidhjen 7, seksion III. Kjo fazë kërkon vlerësimin e ofertave nga ana e një komisioni të ngritur nga MIE-ja, kontrollin e përputhshmërisë nga ana e MPJ/DPBZH-së lidhur me procedurat e ndjekura për zgjedhjen dhe llojin e kontratës që do të nënshkruhet, dhe në rast të një vlerësimi pozitiv, nënshkrimin e secilës kontratë nga ana e MIE-së.

g) Përfshirja e secilës kontratë në Marrëveshjen financiare dhe mënyrat e disbursimit të fondeve, saktësohen në lidhjen 7, seksioni IV.

Neni 6

Mbikëqyrja e Programit

Ecuria e Programit do të mbikëqyret periodikisht dhe bashkërisht sipas skemës së treguesave në lidhjen 4.

Kjo mbikëqyrje do të kryhet nga MPJ/DPBZH-ja, me anë të misionëve periodike të funksionarëve dhe specialistëve të zgjedhur në rast nevojë. MIE-ja do të paraqesë raporte tremujore të monitorimit që do t'i dorëzohen MPJ/DPBZH-së nëpërmjet ambasadës/NJTV. Të dy Palët marrin përsipër të përcaktojnë bashkërisht dhe të realizojnë të gjitha masat që do të quhen të nevojshme për t'u ndërmarrë në momentin kur gjatë zbatimit të Programit, skema e treguesve nuk rezulton e respektuar ose, kur këta të fundit, rezultojnë si jo të përshtatshëm për situatat sektoriale që do të vijnë në të ardhmen.

Neni 7

Mënyrat e përfitimit të shërbimeve, mallrave dhe punimeve

Zgjedhja e shoqërive ekzekutuese të aktiviteteve të programit do të kryhet nëpërmjet zhvillimit të garave në përputhje me dispozitat e përfshira në "Manualin e procedurave" (të adaptuar nga Komisioni Europian në datën 10 nëntor 1999) lidhur me "Dhënien e kontratave të shërbimeve, furnizimit me mallra dhe punimeve në kuadrin e bashkëpunimit komunitar me vendet e treta", sikurse edhe saktësohet në lidhjen 5.

Neni 8

Detyrimet e Qeverisë italiane

Qeveria italiane merr përsipër:

- të garantojë financimin e 41 528 040,03 euro kredi ndihmë;
 - të garantojë financimin e 979 460,51 euro si dhuratë.
- Fondet e sipërtreguara do të bëhen të disponueshme sipas procedurave të mëposhtme:
- fondi dhuratë sikurse saktësohet në lidhjen 6;
 - fondi i kredisë ndihmë do të bëhet i disponueshëm pranë MCC-së dhe do të disbursohet sikurse saktësohet në lidhjen 7, seksioni III e IV.

Neni 9

Detyrimet e Qeverisë shqiptare

Qeveria shqiptare merr përsipër:

të garantojë që KESH-i të vërë në dispozicion burimet financiare respektive prej 9 812 681,08 euro të barasvlefshme për kostot vendore, më mirë të saktësuara në lidhjen 31;

- të bëjë operative të gjitha veprimet, aktivitetet dhe aktet formale të domosdoshme për një ecuri të mirë të Programit të treguar në lidhjen 2;
- të bashkëpunojë me MPJ/DPBZH-në për aktivitetin e mbikëqyrjes së Programit, sipas nenit 6, si dhe të lejojë shqyrtimin e dokumenteve dhe zonave të aktivitetit.

Neni 10

Mosmarrëveshjet

Nëse do të lindin mosmarrëveshje gjatë realizimit të Programit, lidhur me interpretimin ose aplikimin e kësaj Marrëveshjeje, këto do të duhet të diskutohen dhe zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 11

Pengesat dhe forcat madhore

Në rast të një pengimi të realizimit të Programit, i shkaktuar nga një forcë madhore (luftë, përmbytje, zjarr, tufan, tërmet, konflikte pune, greva, masa të qeverive respektive, vështirësi të paparashikueshme në transport dhe shkaqe të tjera) të njohura nga të dy Palët ose në rast rreziku, ose kushte të rrezyrësishme për personelin e huaj, do të merren masat e mëposhtme, të bazuara në rekomandimet e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe të aprovuara nga MPJ/DPBZH-ja:

a) Nëse kohëzgjatja e pengesës së realizimit të Programit është më e vogël se 6 muaj, përdorimi i fondeve të paangazhuara pezullohet derisa MPJ/DPBZH-ja të autorizojë fillimin e aktivitetit.

b) Në rast të kohëzgjatjes së pengesës së realizimit të Programit për më shumë se 6 muaj dhe më pak se 24 muaj, Programi do të ndërpritet. Fondet e paangazhuara do të ruhen derisa të eliminohet pengesa dhe mbërritja e autorizimit të MPJ/DPBZH-së për fillimin e aktivitetit.

c) Nëse kohëzgjatja e pengesës është më e madhe se 24 muaj, Palët janë të detyruara të bien dakord për vazhdimin e Programit dhe të vendosin mbi vazhdimësinë e veprimeve. Në rast të pamundësisë së vazhdimin të aktiviteteve, Palët duhet të vendosin mbi destinacionin e fondeve të paangazhuara.

Në rast të pengesave ose forcës madhore që kanë të bëjnë me disa projekte edhe/ose aktivitete, këto aktivitete dhe fondet që lidhen me to, pezullohen deri në heqjen e pengesave dhe mbërritjes së autorizimit për rinisje të lëshuar nga MPJ/DPBZH-ja. Nëse pengesat vazhdojnë përtej 24 muajve, Palët janë të detyruara të përcaktojnë destinacionin e fondeve të mbetura. Aktivitetet e projekteve që nuk preken nga pengesat mund të vazhdojnë deri në kompletimin e tyre dhe fondet e dhëna për ta vazhdojnë të mbeten të disponueshme.

Neni 12

E drejta e zgjidhjes së Marrëveshjes nga MPJ/DPBZH-ja

MPJ/DPBZH-ja rezervon të drejtën të tërhiqet nga Marrëveshja në rastet e mëposhtme:

- a) mungesë e realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Program;

b) tejzgjatje e pengesës ose e forcës madhore në bazë të nenit 11.

Në të dyja rastet e sipërpërmendura, MPJ/DPBZH-ja mund të vendosë në mënyrë të njëanshme përfundimin e Marrëveshjes, duke njoftuar MIE-në me anë të një note verbale të paktën tre muaj përpara. Në çdo rast, pas një njoftimi të tillë, MIE-ja është e detyruar të ndërpresë aktivitetin e Programit, me përjashtim të ndonjë marrëveshjeje të ndryshme ndërmjet Palëve.

Neni 13

Amendamente

Palët në çdo moment mund të ndryshojnë përmbajtjen e Marrëveshjes me anën e amendamenteve, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 14

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Marrëveshja në fjalë do të hyjë në fuqi në datën e marrjes të njoftimit të dytë nga të dy njoftimet me anë të të cilëve Palët kanë njoftuar zyrtarisht për përmbushjen e procedurave të brendshme respektive të ratifikimit të parashikuara për rastin.

Marrëveshja në fjalë ka një jetëgjatësi prej 3 vjetësh duke filluar nga hyrja në fuqi. Nëse, në fund të 3 vjetëve, aktivitetet e Programit nuk janë kompletuar, Palët mund të bien dakord për një zgjatje të kohës së vlefshmërisë të Marrëveshjes në fjalë, duke u kufizuar në përdorimin e fondeve të mbetura, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Marrëveshja në fjalë mund të denoncohet në çdo moment dhe në rastin kur konstatohen situata të parashikuara në nenin 12. Denoncimi do të ketë efekt 60 ditë nga mbërritja e njoftimit tek Pala që kundërshtohet.

Bërë në Tiranë datë 13.2.2003 në dy origjinale, secila në dy gjuhë italisht dhe shqip. Në rast ndryshimi të interpretimeve, do të merret si bazë teksti në gjuhën italiane.

Duke konfirmuar sa më sipër u shpjegua, nënshkruarit, e autorizuar në mënyrë të duhur nga qeveritë respektive, kanë firmosur Marrëveshjen në fjalë.

PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT

Programi i ristrukturimit teknik e menaxhues i kesh-it dhe fuqizimi i sistemit elektrik shqiptar

Në vazhdim të bashkëpunimit të frytshëm të vendosur në sektorin elektrik që nga viti 1992, i cili ka sjellë deri tani një investim prej rreth 24 milionë euro, nga të cilat afërsisht 3.3 milionë euro dhuratë, MPJ/DPBZH-ja ka rënë dakord në vazhdim të takimeve dypalëshe me Qeverinë shqiptare për Programin në fjalë me një vlerë totale 41 316 552 euro kredi ndihmë dhe 979 460,51 euro falas.

Paralelisht, MPJ/DPBZH-ja ka financuar në dy vitet e fundit një kontratë asistence për drejtuesit kryesorë të KESH-it, me qëllim të mbështetjes hap pas hapi të modernizimit të sistemit të menaxhimit të sektorit elektrik shqiptar.

Përmbajtja e Programit në fjalë pasqyron atë që është përcaktuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar në Tiranë, më datën 10 maj 2000, në bazë të të cilit, të dy palët kanë hartuar një dokument projekti që shpreh në detaje punimet, shërbimet dhe furnizimet e nevojshme për zbatimin e tij.

Nëpërmjet Programit të tanishëm, që integrohet me ato të donatorëve të tjerë (Banka Botërore, BEI, BERZH, Japoni, Zvicër, Spanjë dhe Norvegji) për një impenjim tërësor prej më tepër se 200 milionë dollarë do të kontribuojë në fuqizimin e sistemit elektrik të transmisionit dhe shpërndarjes shqiptar, si dhe do të përmirësojë anën organizative të KESH-it, duke favorizuar shëndoshjen teknike dhe financiare.

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Duke pasur parasysh që përmirësimi i shërbimit elektrik do të mundësojë një përmirësim të nivelit të jetës së popullit dhe do të favorizojë investimet e reja të kapitaleve të huaja në vend, objektivi i veçantë që mendohet të arrihet është:

Të mundësohet organizimi i KESH-it në përputhje me kriteret bashkëkohore të menaxhimit, duke favorizuar një pavarësi graduale financiare dhe përfshirjen (integrimin) e saj në sistemin elektrik rajonal.

Duke arritur një pavarësi teknike dhe financiare, KESH-i mund të garantojë një vazhdimësi në sigurimin e shërbimeve ndaj popullatës dhe sektorëve prodhues të vendit.

Për arritjen e një objektivi të tillë, janë të domosdoshme masat politike shoqëruese që Qeveria shqiptare merr përsipër të kryejë: (i) zbatimin e planit të riorganizimit të KESH-it; (ii) përshtatja e vazhdueshme e tarifave të energjisë elektrike me kostot operative dhe të investimeve të KESH-it.

REZULTATET E PRITSHME

Me qëllim të arritjes së objektivit të veçantë të sipërpërmendur, është parashikuar që në harkun kohor trevjeçar të Programit, të arrihen rezultatet që vijnë:

1. riorganizimi i KESH-it sipas kriterëve bashkëkohore të drejtimit;
2. zgjidhja hap pas hapi e krizës financiare të KESH-it;
3. përmirësimi i sigurisë së shërbimit elektrik.

E gjithë kjo mund arrihet nëpërmjet:

- zbatimit të planit të “unbundling” (ndarjes së prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes) në organizimin teknik dhe financiar të KESH-it;

- mbledhjes së faturave të paktën në 80 % të energjisë së faturuar;

- riorganizimit të tarifave (familjare dhe jo) mbi baza trevjeçare, nga ana e autoritetit të sektorit (Enti Rregullator i Energjisë Elektrike-ERE);

- planifikimit të kthimit (rimbursimit) të borxheve ndaj KESH-it;

- asistencës së Qeverisë shqiptare për KESH-in për mbledhjen e rregullt të faturave;

- zvogëlimin të humbjeve (teknike dhe jo) në 35% në vitin 2003 dhe në 26% në vitin 2005; rritjes së arketimeve të Entit të paktën në 85 % në vitin 2003 dhe në 95 % në vitin 2005;

- planit të blerjes së energjisë elektrike nga jashtë (në vitet 2003-2004).

Në përfundim të tre viteve të parashikuara për realizimin e Programit, synohet të arrihen treguesit e efektivitetit që vijnë: i) humbje jo teknike më të vogla se 20 %, ii) humbje të tensionit në transmetim më të vogël se 10 % dhe iii) përmirësim në vazhdueshmërinë e shërbimeve në bazë vjetore prej të paktën 50% në krahasim me vlerat e arritura në qershor 2002.

Aktivitetet që do të kryhen për të arritur rezultatet

Për secilin nga rezultatet e paraqitura më sipër, parashikohen për t'u realizuar aktivitetet që vijnë:

1. Riorganizimi i qëndrueshëm i KESH-it
 - a) Shërbime inxhinierike, projektimin e ndërhyrjeve, duke përfshirë qendrën e re dispeçer dhe për asistencë të natyrës teknike për KESH-in për zhvillimin e garave dhe realizimin e projekteve.
 - b) Shërbime profesionale për asistencë për drejtuesit kryesorë të KESH-it në ristrukturimin e saj sipas skemës së “unbundling” (ose të ndarë në prodhim, transmetim dhe shpërndarje) duke përfshirë edhe transferimin “know-how” për personelin e saj.
 - c) Ndërtimi i zyrave të reja qendrore dhe rehabilitimi i atyre periferike.
 - d) Furnizimi i makinave për lëvizjen e personelit.
2. Zgjidhja hap pas hapi e krizës financiare të KESH-it
 - a) plotësimi i sistemit të kompjuterizuar të faturimit;
 - b) blerja dhe instalimi i matësve të energjisë elektrike (Tiranë/Durrës, Pogradec).
3. Shërbim elektrik më efektiv dhe i sigurtë
 - a) furnizimi i materialeve dhe mjeteve vetëlëvizëse për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes;
 - b) ndërtimi i një nënstacioni të ri 220/110 kv-Tirana 2;
 - c) plotësimi i nënstacionit 110/20 kv-Kashar;
 - d) ndërtimi i një nënstacioni të ri (të mbyllur) 110/20 kv, Tirana-Qendër;
 - e) fuqizimi i nënstacionit 110/20 kv- Pogradec;
 - f) zgjerimi i rrjetit të shpërndarjes 20 kv të Durrësit;
 - g) zgjerimi i rrjetit të shpërndarjes 10 kv të Pogradecit.

Bëhet fjalë për ndërhyrje të karakterit strukturor, teknik dhe organizativ, që pasqyrojnë kompleksitetin dhe lidhjen e ngushtë të problemeve për t'u përballuar e që nuk mund të realizohet pa një sforcim të përbashkët të bashkësisë së donatorëve (Banka Botërore, BERZH, BEI, Japonia, Spanja, Zvicra dhe Norvegjia), si dhe nga vetë Qeveria shqiptare.

Një rol themelor do të kryhet nga asistencë për drejtuesit e KESH-it, për të adresuar dhe mbikëqyrur ndërhyrjet e veçanta organizative dhe menaxhuese që duhet të ndërmerren.

Programi parashikon gjithashtu dhe një seri masash të nevojshme për të siguruar menaxhimin e saktë të tij:

- a) Do të ngrihet pranë MIE-së një PMU, që do të përfitojë nga mbështetja teknike dhe financiare e vetë Programit.
- b) Do të sigurohen nga ana e MPJ/DPBZH-së, të gjitha burimet e nevojshme për mbikëqyrjen e vetë Programit.
- c) Do të sigurohen nga ana e KESH-it të gjitha burimet financiare për të mbuluar të gjitha kostot vendore në përkatësi të saj (punimet ndërtimore, detyrimet doganore, TVSH-në etj.).

Duke pasur parasysh që KESH-i e ka adaptuar statutin e tij të ri, parakushti për fillimin e secilit projekt që bën pjesë në Program është si më poshtë:

Për secilën garë, KESH-i duhet të garantojë burimet financiare të nevojshme për të mbuluar kostot vendore të sipërpërmendura që janë në kompetencë të saj.

Skema financiare treguese e Programit jepet në lidhjen 3.

LIDHJA 2

KUSHTET E REALIZIMIT

Duke pasur parasysh që KESH-i e ka përshtatur tashmë statutin e tij të ri, për realizimin e Programit në fjalë Qeveria shqiptare merr përsipër të kryejë:

1. parakushtet e treguara në tabelën e mëposhtme;
2. masat përkatëse të ilustruara në tabelë;
3. të përshtasë, sipas afateve kohore të treguara në tabelë, masat e domosdoshme për arritjen e rezultateve.

		Parakushtet
		Për secilën garë, KESH-i duhet të garantojë burimet financiare të nevojshme për të mbuluar kostot lokale që janë në përkatësi të saj (punimet ndërtimore, detyrimet doganore, TVSH-në). Shumat në ngarkim të KESH-it duhet të jenë të përfshira në buxhetin përkatës vjetor, përpara njoftimit të zhvillimit të secilës garë.
Logjika e ndërhyrjes		Kushtet
Objektivi i veçantë	Rritja hap pas hapi e pavarësisë së menaxhimit të KESH-it sipas kriterëve bashkëkohore (në një sistem efektiv rajonal).	1. Zbatimi i planit të riorganizimit të KESH-it (unbundling) tashmë i miratuar në datën 8.4.2002 (Politikat sektoriale të energjisë elektrike). 2. Përshtatja e vazhdueshme e tarifave të energjisë elektrike me shpenzimet operative dhe investimet e KESH-it.
Rezultatet e pritëshme	1- Përmirësimi hap pas hapi i krizës financiare të KESH-it.	1- Impenjimi nga ana e qeverisë të pagesës së faturave të prapambetura (2003-2005) dhe të faturave aktuale të klientëve buxhetorë dhe jobuxhetorë (duke filluar nga viti 2003). 2- Përshtatja graduale e rritjes së tarifave të energjisë elektrike. 3- Kthimi i TVSH KESH-it sipas kërkesave të ligjeve përkatëse shqiptare në fuqi. 4- Legalizimin e përdoruesve të energjisë elektrike (brenda vitit 2005) dhe pagimi i rregullt i faturave të energjisë elektrike (policia elektrike).
	2- Shërbim elektrik më efektiv dhe i sigurt.	Realizimi i ndërhyrjeve.
	1-Shërbimet inxhinierike për projektimin e ndërhyrjeve, përfshirë dhe qendrën e re dispeçer	Miratimi i planit të prokurimit. Identifikimi i vendit ku do të ndërtohet qendra e re dispeçer.
	2- Shërbime të asistencës për drejtuesit kryesorë dhe divizioneve të KESH-it (prodhim, transmetim, shpërndarje).	Identifikimi i roleve kyçe përpara bërjes efektive të kontratës.
	3- Ndërtimi i godinës së re administrative të KESH-it dhe rehabilitimin e atyre rajonale.	Toka, ku do të ngrihet ndërtesa e re administrative e KESH-it, duhet të jetë e disponueshme përpara publikimit të njoftimit të garës.
	4- Blerja e makinave.	

Aktiviteti	5- Plotësimi i sistemit të faturimit dhe vjeljes së faturave të energjisë elektrike.	Identifikimi i zonave të përzgjedhura të shpërndarjes të ngarkuara me lëshimin dhe vjeljen e faturave.
	6- Blerja e matësve të energjisë elektrike dhe vendosja e tyre në zonat e paracaktuara.	Respektimi nga ana e KESH-it i programit për vendosjen dhe montimin e tyre.
	7- Blerja e mjeteve vetëlëvizëse dhe pajisjeve për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes.	
	8- Nënstacioni Tirana 2.	Vënia në dispozicion të terrenit, ku do të ngrihet nënstacioni, përpara publikimit të njoftimit të garës.
	9-Kompletimi i nënstacionit të Kasharit.	
	10- Nënstacioni Tirana Qendër (i mbyllur)	Vënia në dispozicion të terrenit, ku do të ngrihet nënstacioni, përpara publikimit të njoftimit të garës.
	11-Fuqizimi i nënstacioni të Pogradecit.	
	12- Rrjeti i shpërndarjes Durrës.	Plotësimi i projekteve ekzekutive dhe përfundimi i procedurave për kërkesat për lejet e kalimit, përpara përfshirjes së kontratës në linjën e kredise.
	13- Rrjeti i shpërndarjes Pogradec.	Plotësimi i projekteve ekzekutive dhe përfundimi i procedurave për kërkesat për lejet e kalimit, përpara përfshirjes së kontratës në linjën e kredisë.
	14- Mbështetje dhe shërbim të asistencës për PMU-në për menaxhimin e Programit. (Falas)	Ngritja e PMU-së.
	15- Mbikëqyrja e Programit nga DPBZH-ja (Falas)	Fillimi i aktiviteteve.

Të dy Palët do të marrin përsipër të përcaktojnë bashkërisht dhe të zbatojnë të gjitha masat, që do të quhen të nevojshme për t'u ndërmarrë kur, gjatë realizimit të Programit, vërtetohet pamundësia e plotësimit të kushteve të sipërpërmendura.

LIDHJA 3

BURIMET FINANCIARE

Me qëllim të mundësimit të realizimit të Programit në fjalë, të dy Palët marrin përsipër për të bërë të disponueshme burimet financiare sipas tabelës së mëposhtme.

Aktiviteti	Përshkrimi	Kredi ndihmë (Euro)	Dhuratë (Euro)	Kosto vendore (Euro)	Totali (Euro)
Shërbime inxhinierike për projektimin dhe asistencë të natyrës teknike për KESH-in.	Kontratë shërbimesh (Firmë konsulence)	1 806 308,00	0	0	1 806 308,00
Projektimi i qendrës së re dispeçer	Kontratë shërbimesh (Firmë konsulence)	555 191,17	0	0	555 191 17
Shërbime asistencë menaxhimi për drejtuesit kryesorë të KESH-it.	Kontratë shërbimesh (Ndërmarrje publike elektrike).	3 350 805,00	0	0	3 350 805,00
Ndërtimi i zyrave të reja qendrore dhe rehabilitimi i 8 zyrave rajonale të KESH-it.	Kontratë punimesh dhe furnizim mallrash.	4 570 643,56	0	516 456,90	5 087 100,46
Blerje makinash për personelin e KESH-it.	Kontratë furnizim mallrash.	568 102,59	0	0	568 102,59
Plotësimi i sistemit të faturimi dhe vjeljes së faturave elektrike.	Kontratë shërbimesh dhe furnizim mallrash.	1 143 952,03	0	0	1 143 952,03
Blerja dhe instalimi i matësve të energjisë elektrike.	Kontratë furnizim mallrash (instalimi në ngarkim të KESH-it).	5 035 454,77	0	2 711 398,72	7 746 853,49
Blerje makinash dhe pajisjesh për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes.	Kontratë furnizim mallrash.	4 493 175,02	0	0	4 493 175,02
Nënstacioni Tirana 2.	Kontratë me çelësa në dorë.	6 925 687,02	0	516 456,90	7 442 143,92
Kompletimi i nënstacionit të Kasharit.	Kontratë furnizimi mallrash.	877 976,73	0	0	877 976,73
Nënstacioni Tirana Qendër (i mbyllur).	Kontratë me çelësa në dorë.	4 364 060,80	0	516 456,90	4 880 517,70

Fuqizimi i nënstacionit të Pogradecit.	Kontratë furnizim mallrash.	857 318,45	0	0	857 318,45
Rrjeti i shpërndarjes Durrës.	Kontratë furnizim mallrash (punimet civile në ngarkim të KESH-it).	5 164 568,99	0	1 601 016,39	6 675 585,38
Rrjeti i shpërndarjes Pogradec.	Kontratë furnizim mallrash (punimet civile në ngarkim të KESH-it).	1 813 796,63	0	723 039,66	2 536 836,29
Asistencë për PMU-në dhe mbikëqyrjen e Programit	Misione të DPBZH-së–Fondi i ekspertëve.	0	817 293,04	0	817 293,04
Mbështetje për PMU-në.	Pagesat për pajisjet, shpenzimet për veprimtarinë e personelin.	0	162 167,47	0	162 167,47
Detyrimet doganore, etj.	Taksat lokale.	0	0	3 227 855,62	3 227 855,62
	Shuma	41 528 041,03	979 460,51	9 812 681,08	52 320 182,62

Kontributi i Qeverisë italiane do të jetë:

Kredia ndihmë 41 528 041,03 euro

Dhuratë 979 460,51 euro

Totali 42 507 501,54 euro

Kontributi i KESH-it:

Kosto lokale 9.812.681,08 euro

Shpenzimet e përgjithshme të Programit rezultojnë të jenë 52 320 182,62 euro.

Mbikëqyrja dhe Treguesit

Me qëllim të vlerësimit bashkërisht të efektivitetit dhe efektshmërisë së programit, dhe rrjedhimisht të konkretizimit të rezultateve që propozohen për t'u arritur, të dy Palët marrin përsipër të zbatojnë planin e mbikëqyrjes të dhënë në tabelën që vijon.

Tregues objektivisht të kontrollueshëm	Burimet e kontrollit
A- Plani i riorganizimit të KESH-it në divizione të veçanta.	A-Raportet e asistencës për menaxhim të KESH-it dhe mbikëqyrja.
B- Vendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e planit trevjeçar për rritjen e tarifave.	B- Raportet e asistencës për menaxhim të KESH-it dhe mbikëqyrja.
C- Organizimi i marrëdhënieve të reja me përdoruesit dhe me personelin, treguesit financiarë të shoqërisë që influencojnë në faturën ekonomike vjetore (2005) me humbjet operative më pak se 10%. - vënia në jetë të planit “të ndarjes”(“unbundling”) në organizimin teknik dhe financiar të Kesh-it; - vjelja e faturave të paktën për 80 % të energjisë së faturuar; - riorganizimi i tarifave (shtëpiake dhe jo) me bazë tre-vjeçare nga ana e autoritetit të sektorit (Enti Rregullator i Energjisë Elektrike-ERE); - plani i kthimit të borxheve ndaj Kesh-it; - asistencë nga ana e Qeverisë shqiptare për KESH-in për vjeljen e rregullt të faturave; - zvogëlimi i humbjeve (teknike dhe joteknike) në 35 % në vitin 2003, dhe 26 % në vitin 2005; rritja e arkëtimeve të faturave nga 85 % në vitin 2003 dhe 95 % në vitin 2005; - plani i blerjes së energjisë jashtë vendit në vitet 2002 dhe 2003.	Raportet e asistencës për menaxhim të KESH-it dhe mbikëqyrja. Buxheti vjetor i KESH-it. Dokumenti i programimit ekonomik dhe financiar të Qeverisë shqiptare.

Mbikëqyrja do të realizohet nga MPJ/DPBZH-ja, nëpërmjet dërgimit të misionëve të veçanta periodike.

MIE-ja do t'i dërgojë MPJ/DPBZH-së raporte tremujore të mbikëqyrjes nëpërmjet Ambasadës italiane (NJTV).

Të dy Palët, marrin përsipër, për të përcaktuar bashkërisht dhe zbatuar të gjithë masat që do të quhen të nevojshme për t'u ndërmarrë, kur gjatë realizimit të Programit, skema e treguesve nuk rezultojnë të respektuar.

GARA E SHËRBIMEVE, E MALLRAVE DHE PUNIMEVE (KUSHTE TË VEÇANTA)

Kjo lidhje i referohet përdorimit të kredisë ndihmë italiane.

Dhënia e kontratave do të bëhet nëpërmjet zhvillimit të garave të hapura, të rezervuara për shoqëri italiane (me parakualifikim në rastin e kontratave të shërbimeve).

Përqindja e kredisë ndihmë e përdorshme për kostot lokale dhe/ose në vende të treta nuk mund të kalojë 35% të vlerës së kredisë.

Për zhvillimin e të gjitha garave të parashikuara në Program, do të zbatohen procedurat e parashikuara në Manualin e procedurave (të vënë në veprim nga Komisioni European në 10 nëntor 1999) në lidhje me: Dhënien e kontratave të shërbimeve, mallrave dhe punimeve, në kuadrin e bashkëpunimit komunitar me vendet e treta.

Në çdo rast, procedura e zgjedhjes do të duhet të përfshijë:

1.Kontrollet e përshtatshmërisë së ofertuesve (persona juridikë, shoqëri dhe ndërmarrje) nuk do të quhen të përshtatshme në rast se:

a) janë në gjendje falimentimi, të likuidimit, të administrimit të kontrolluar ose të pajtimit paraprak, të mbylljes së aktivitetit, ose që janë objekt i një ndjekjeje të ngjashme të parashikuara nga ligjet ose rregullat vendore;

b) janë objekt i një procedure të deklarimit të falimentimit, të likuidimit, të administrimit të kontrolluar, të pajtimit paraprak ose të një ndjekjeje të ngjashme të parashikuar nga ligjet dhe rregullat vendore;

c) kanë qenë dënuar nga një vendim i paapelueshëm për një faj që lidhet me moralin profesional;

d) janë shpallur përgjegjës për shkelje të rënda të detyrave profesionale, të provuara me çfarëdo elementi dokumentues pranë administratës gjyqësore;

e) nuk janë në rregull me detyrimet në lidhje me kontributet sociale sipas dispozitave ligjore të vendit në të cilin janë vendosur;

f) nuk janë në rregull me detyrimet në lidhje me pagimin e taksave, të kërkuara nga ligji i vendit të qëndrimit;

g) janë shpallur fajtorë për pasaktësi të rënda gjatë dhënies së informacioneve të kërkuara nga ana e administratës gjyqësore në lidhje me sa më sipër;

h) janë deklaruar fajtorë, për shkak të mos respektimit të detyrimeve kontraktuale, të mosplotësimeve të rënda në lëndën e ekzekutimit, në kuadrin e një kontrate të nënshkruar me të njëjtën administratë gjyqësore ose në kuadrin e një kontrate tjetër të financuar nëpërmjet fondeve komunitare.

Për më tepër, ofertuesit italianë janë të detyruar të paraqesin një certifikatë ose një deklaratë të barasvlefshme të mospërkatësisë në kategoritë e treguara në Dekretin Ligjor Italian (8.8.1994, 490-“antimafia”).

Ofertuesit do të duhet që për këtë të paraqesin, së bashku me ofertat e tyre, provat e nevojshme, në përputhje me ligjet e vendit në të cilin janë të vendosur, që vërtetojnë se ata nuk gjenden në asnjë nga situatat e parshikuara në pikat (a),(b),(c),(e) dhe (f).

2.Verifikimi i gjendjes ekonomiko-financiare të ofertuesve nëpërmjet:

a) një deklaratë për kapitalin e shoqërisë dhe të faturimeve në tre vitet përpara zhvillimit të garave;

b) një deklaratë e faturimeve të përgjithshme të konkurrentëve dhe në rast të bashkëpunimit të përkohshëm, të ardhurat e secilit prej pjesëmarrësve;

c) një deklaratë që të tregojë të ardhurat e sektorëve specifikë, të cilëve gara i referohet ose sektorit në të cilin, në rast të krijimit të një lidhjeje bashkëpunimi, të përkohshëm shoqëria vetë ka ndërmend të marrë pjesë;

d) një deklaratë të përshtatshme të përfaqësuesve ligjorë ose një certifikatë bankare, që përmban informacione lidhur me marrëdhëniet me institucionet bankare me rëndësi ndërkombëtare për të dëshmuar pranueshmërinë tregtare dhe financiare të konkurrentëve dhe të shoqërive që formojnë një lidhje bashkëpunimi të përkohshëm;

e) një kopje të certifikatës së Dhomës së Tregtisë në vendin që ai është vendosur, ku konkurrenti bën pjesë si anëtar i saj;

f) në rast të një lidhjeje bashkëpunimi të përkohshëm, duhet të paraqitet një kopje e kontratës së lidhjes së bashkëpunimit, ku të tregohet shoqëria, e cila do të ketë rolin udhëheqës e që do të jetë përgjegjësjë kryesore ndaj MIE-së në rastin e zbatimit të kontratës.

3. Verifikimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të konkurruesve nëpërmjet:

a) kopjeve të dokumenteve origjinale që dëshmojnë strukturën ligjore dhe/ose statusin juridik dhe që përcaktojnë vendin e regjistrimit dhe/ose selinë kryesore ose zyrën e regjistrimit, dhe nëse këto nuk përputhen, vendndodhjen e selisë kryesore të kompanisë, shoqërisë ose partnershipit të zakonshëm ose të pjesëve të ndryshme që përbëjnë konkurrentët, në rast të një lidhjeje bashkëpunimi të përkohshëm;

b) një raport që përmban informacione të dokumentuara mbi eksperiencat e mëparshme të punës të konkurrentëve ose të lidhjeve bashkëpunuese të përkohshme për garat që kanë pasur natyrë të ngjashme për tre vitet e fundit paraardhës, si dhe për ato që i përkasin garave të tjera në zhvillim me informacione të veçanta, për një pjesëmarrje efektive dhe konkrete në secilën garë;

c) kualifikimet dhe eksperiencat e anëtarëve kryesorë të stafit që do të ngarkohen nga kontraktuesi për zbatimin e kontratës;

d) një raport të shkurtër mbi aktivitetin e konkurrentëve të veçantë ose pjesëtarë në një lidhje të përkohshme, duke iu referuar veçanërisht aktiviteteve në lidhje me Programin.

Krahasimi dhe vlerësimi i konkurrentëve, mbi bazën e kriterëve të vlerësimit të përcaktuar në njoftimin dhe në dokumentet e garës, do të bëhet duke përdorur kriteret e paravendosura dhe çmimin, duke përcaktuar kështu konkurrentin më të leverdisshëm ekonomikisht.

Kriteret duhet të jenë të sakta, jodiskriminuese dhe as paragjyquese për të siguruar zhvillimin e një gare korrekte.

LIDHJA 6

PMU-JA PËR ADMINISTRIMIN E PROGRAMIT

Me qëllim që të sigurohet koordinimi i nevojshëm ndërmjet entit financues dhe institucioneve të ndryshme apo shoqërive pjesëmarrëse në realizimin e Programit, do të ngrihet në Ministrinë e Industrisë dhe Energjitikës një “Njësi e menaxhimit të projektit” (PMU), për financimin e të cilës janë vënë në dispozicion 162 167,47 euro falas.

Në veçanti, PMU-ja duhet të realizojë detyrat e mëposhtme:

- Përgatitjen, së bashku me KESH-in të planit të prokurimit të të gjithë Programit (me asistencën e misionëve të DPBZH-së).

- Përgatitjen, në bashkëpunim me KESH-in të dokumentacionit të garave për zgjedhjen e shoqërisë së konsulencës e ngarkuar me shërbimet e inxhinieringut (me asistencën e misionëve të DPBZH-së);

- Përgatitjen, në bashkëpunim me KESH-in të dokumentacionit të garave për furnizimet më urgjente (me asistencën e misionëve të DPBZH-së).

- Kontrolli i dokumentacionit të garave, të parapërgatitura nga shoqëria e konsulencës e sipërpërmendur, për sigurimin e të gjitha shërbimeve, mallrave dhe punimeve të parashikuara në Program;

- Përgatitja dhe prodhimi i të gjitha dokumenteve të garave.

- Ndihmë për komisionin e vlerësimit të ofertave të caktuara nga MIE-ja.

- Kontrolli, në bashkëpunim me KESH-in dhe mbështetjen teknike të shoqërisë së konsulencës (1), i realizimit të të gjithë Programit, duke treguar veprimet e nevojshme për t'u kryer në rast të vonesave që mund të kompromentojnë përfundimin e mirë të tij.

¹ Në fakt, për funksionet saj dhe përgjegjësinë e natyrës teknike, KESH-i do të përfitojë nga asistencë e shoqërisë së konsulencës, e cila do të ketë detyrat e përgjithshme të mëposhtme:

- Përgatitjen e dokumentacionit të garave të projekteve të ndryshme nga të cilat përbëhet Programi (shërbime, mallra dhe punime).

- Asistencë të natyrës teknike gjatë fazës së zbatimit të këtyre projekteve.

- Miratimin e pagesave në përputhje me kushtet kontraktuale.
- Kontrollin e grafikut të realizimit të punimeve.
- Sinjalizimin e çfarëdo lloj anomalie në lidhje me aspekte të karakterit mjedisor ose lidhur me mungesën e respektimit të normave të sigurisë gjatë punës.

PMU-ja do të ndihmohet nga asistenca teknike e ofruar nga MPJ/DPBZH-ja, nëpërmjet misioneve afatshkurtra/gjata të konsulentëve me eksperiencë të veçanta të sektorit:

- gjatë fazës fillestare të projektit: misioni afatshkurtra të ekspertëve me eksperiencë të veçanta në fushën specifike tekniko-kontraktuale për ndihmesë në përgatitjen e planit të prokurimit dhe të dokumentacionit të garave në lidhje me zgjedhjen e shërbimeve inxhinierike dhe furnizimit të mallrave më urgjente;

- gjatë fazës së realizimit: misioni të ekspertëve nga sektori elektrik me afat të shkurtër dhe të gjatë, kjo e fundit bazuar në llojin e ndryshëm dhe të gjërë të ndërhyrjeve të parashikuara në Program.

Në veçanti, ekspertët me mision afatgjatë do të bashkëpunojnë me Pmu-në dhe Ambasadën italiane/NJTL për kryerjen e aktiviteteve kryesore të mëposhtme:

- asistencë për PMU-në për të gjitha aktivitetet tekniko-administrative të kompetencës;
- hartimin e raporteve tremujore për aktivitetin e PMU-së;
- mbështetje për raportimin e shpenzimeve të bëra nga Programi.

Kuptohet që, as ekspertët italianë dhe as personeli i ambasadës/NJTV nuk mund të marrin pjesë në komisionin e vlerësimit të garave, detyrë kjo ekskluzive e palës shqiptare.

PMU-ja do të ketë një staf shqiptar, të caktuar nga MIE-ja dhe të miratuar nga ambasada/NJTV:

- një drejtor, më formim dhe titull të inxhinierit elektrik;
- një asistent;
- një administrator kontratash;
- një shofer.

Personeli i mësipërm duhet të ketë njohuri të mira për gjuhën italiane. Me nisjen e Programit, do të përcaktohen me detaje detyrat ("job description") e personave të sipërpërmendur.

Duke pasur parasysh, rritjen e aktiviteteve dhe numrin e personelit të nevojshëm, në krahasim me atë të parashikuar në PMU/ICAP-3 ekzistente, MIE-ja ka vënë në dispozicion një dhomë tjetër, në mënyrë që të sigurohen hapësirat e nevojshme për punën e 6 personave (4 shqiptarë dhe 2 italianë).

Kontributi i MPJ/DPBZH-së për funksionimin e PMU-së është i barabartë me 162 167,47 euro falas, të ndara si më poshtë:

- stimuli/rroga për personelin shqiptar për 36 muaj, me një vlerë prej 38,280 euro;
- rehabilitimi i ambienteve dhe shërbimeve sanitare, pajisja e zyrave me një vlerë prej 24 800 euro;

- blerja e një autoveture 4x4, me një vlerë prej 25 000 euro;
- shpenzime të përgjithshme të administrimit (karburanti, mirëmbajtja, kancelaritë dhe dërgim postar) me një vlerë prej 74 087,47 euro.

Stimujt/rroga për personelin shqiptar do të paguhet çdo muaj me paraqitjen e një raporti të aktivitetit të hartuar nga drejtori i PMU-së dhe miratuar nga ambasada/NJTV.

Kontributi i MIE-së për funksionimin e PMU-së do të përbëhet nga zërat e mëposhtëm:

- vënia në dispozicion i dy ambienteve dhe shërbimeve sanitare;
- pagimi i rrogave të drejtorit dhe administratorit të kontratave;
- pagimi i energjisë elektrike dhe telefonave fiks.

Për të asistuar PMU-në dhe për të mbikëqyrur Programin, MPJ/DPBZH-ja ka, gjithashtu miratuar dhe fondet e mëposhtme falas:

- 309 874,14 euro për të mbuluar kostot e personelit italian të dërguar me misioni afatshkurtra/gjata për të asistuar PMU-në;
- 507 418,91 euro për të mbuluar kostot e personelit italian të dërguar me misioni afatshkurtra për të mbikëqyrur të gjithë Programin.

FORMALITETET E EKZEKUTIMIT DHE MENAXHIMIT TË KREDISË

Seksioni I NISJA E AKTIVITETIT DHE MIRATIMIT TË PLANIT TË PROKURIMIT

1. PMU-ja, me asistencën e misionëve të DPBZH-së dhe në bashkëpunim me KESH-in, do të përgatisë propozimin për planin e prokurimit, i cili do të transmetohet nga ana e MIE-së tek MPJ/DPBZH-ja, nëpërmjet ambasadës/NJTV.

2. Plani i prokurimit duhet të jetë i organizuar në bazë të garave (të cilat mund të jenë të ndara në lote), duke treguar shumat në dispozicion (vlerë orientuese) dhe tipin e garës që do të ndiqet (sipas procedurave të lidhjes 5). Kjo nënndarje duhet të marrë parasysh mundësinë e kryerjes së shpenzimeve në Shqipëri ose vende të treta deri në një kufi maksimal prej 35% të vlerës së kredisë.

3. PMU-ja do të zhvillojë vetëm gara të hapura, të rezervuara vetëm për firma italiane (me parakualifikim në rastin e kontratave të shërbimit). Në rastin kur MIE-ja do ta quajë të nevojshme të procedojë me metoda të thjeshtuara, duhet të bëjë një kërkesë të motivuar për një përjashtim nga rregullat nga ana e MPJ/DPBZH-së.

MPJ/DPBZH, do të shqyrtojë planin e prokurimit nga pikëpamjet tekniko-ligjore, dhe në rast të një vlerësimi pozitiv do ta aprovojë, duke i dërguar MIE-së një njoftim zyrtar, nëpërmjet ambasadës/NJTV.

Seksioni II Vënia në qarkullim e njoftimit të garave, procedurat që do të ndiqen

A. PMU-ja do të përgatisë dokumentacionin teknik të nevojshëm për zhvillimin e garave respektive. Ky dokumentacion do të jetë në përputhje me lidhjen 5, e cili i referohet manualit të procedurave (të vëna në veprim nga Komisioni Europian në 10 nëntor 1999) në lidhje me dhënien e kontratave të shërbimeve, mallrave dhe punimeve, në kuadrin e bashkëpunimit komunitar me vendet e treta.

Dokumentacioni duhet, në çdo rast:

- të specifikojë “kushtet speciale” që i përkasin çdo gare;
- të japë qartësisht kriteret e vlerësimit që do të vihen në zbatim nga ana e komisionit të vlerësimit të ngritur nga MIE-ja).

B. Mënyra e procedimit

B.1 Përgatitja e dokumentacionit të garave:

- Garat për zgjedhjen e shoqërisë së konsulencës dhe për blerjen e mallrave më urgjente: PMU-ja, me ndihmën e misionëve të DPBZH-së dhe në bashkëpunim me Kesh-in, përgatit dokumentacionin përkatës të garës për zgjedhjen e të ngarkuarit me ekzekutimin e kontratës.

- Garat për të gjitha projektet e tjera të shërbimeve, mallrave dhe punimeve: PMU-ja do të kontrollojë në bashkëpunim me KESH-in, dokumentacionin e garës së përgatitur nga shoqëria e konsulencës.

B.2 Kontrolli i përputhshmërisë së dokumentacionit të garave

Dokumentacioni i garave për secilin projekt do të dërgohet nga ana e PMU-së tek MPJ/DPBZH-ja, nëpërmjet ambasadës/NJTV së bashku me kërkesën e publikimit të njoftimit të zhvillimit të garës për të kontrolluar përputhshmërinë me marrëveshjen në fjalë. Ky kontroll do të konsistojë në veçanti mbi përputhshmërinë:

- e garës me planin e prokurimit të miratuar;
- e përmbajtjes ligjore me procedurat e shprehura në lidhjen 5;
- e specifikimeve teknike dhe parametrave të vlerësimit me objektivat që programi synon të arrijë.

B.3 Publikimi i njoftimit të zhvillimit të garës

Në rast të një vlerësimi pozitiv, njoftimi për garën do të publikohet, nga ana e MPJ/DPBZH-së, në të përditshmet italiane, në Buletinën e Kooperacionit dhe në faqen e internetit të MPJ-së. MIE-ja do të procedojë dhe ajo me publikimin në gazetën shqiptare.

Seksioni III Faza e vlerësimit dhe përcaktimit të fituesit-procedurat që do të ndiqen

A. Zhvillimi i garës dhe kontrolli i përputhshmërisë me kriteret e vendosura nga komisioni i vlerësimit:

- PMU do të ndjekë ecurinë e çdo gare, duke asistuar edhe komisionin e vlerësimit të ofertave (të caktuara nga MIE-ja.

- Me përfundimin e procesit të vlerësimit, përpara shpalljes së fituesit të garës, PMU-ja do t'i

kërkojë DPBZH-së të bëjë kontrollin e përputhshmërisë së garës.

B. Mënyra e procedimit

B.1 Për secilën garë, PMU-ja do të dërgojë dokumentacionin që përmban rezultatet e vlerësimit të ofertave në Ambasadën italiane/NJTV, e cila do të ia përcjellë ato DPBZH (me komentet eventuale përkatëse).

B.2 MPJ/DPBZH-ja, do të kontrollojë kryesisht përputhshmërinë ligjore dhe teknike të vlerësimeve të bëra me procedurat dhe kriteret e parametrat e parashikuara në dokumentet e garës.

B.3 Pas përfundimit të verifikimeve, MPJ/DPBZH do të informojë PMU-në, nëpërmjet ambasadës/NJTV, mbi rezultatin e tyre (miratimin-nulla osta).

B.4 Në rastin e një vendimi pozitiv, MIE-ja e asistuar nga PMU-ja, do të procedojë me lidhjen e kontratës me shoqërinë që ka rezultuar fituese.

Seksioni IV Faza e përfshirjes së kontratës në linjën e kredisë dhe disbursimit - procedurat që do të ndiqen

A.1 Kontratat e lidhura ndërmjet firmave fituese dhe MIE duhet të dërgohen tek MPJ/DPBZH-ja nëpërmjet ambasadës/NJTV të Tiranës së bashku me kopjen e garancisë së ekzekutimit të kontratës “performance bond”, së bashku me miratimin nulla osta dhe një deklaratë impenjimi nga Pala shqiptare në të cilën merren përsipër pagimi i kostove lokale (punimet ndërtimore, taksat, detyrimet doganore).

B. Mënyra e procedimit

B.1 Me marrjen e dokumentacionit, MPJ/DPBZH-ja do të marrë masat për të lëshuar miratimin “nulla osta” që autorizon Mediocredito Centrale, të përfshijë kontratën në Marrëveshjen financiare.

B.2 Mediocredito Centrale do t’u kërkojë shoqërive italiane të interesuara një “deklaratë angazhimi,” që mallrat dhe shërbimet janë me origjinë italiane dhe që shpenzimet që mund të bëhen në vend (Shqipëri) dhe/ose në vende të treta të industrializuara nuk mund të kalojnë vlerën e kuotës së përcaktuar në secilën kontratë, si dhe paraqitjen e një certifikate antimafie.

Mediocredito Centrale do t’i kërkojë huamarrësit shqiptar plotësimin e kërkesës së vënies në dispozicion të fondeve dhe të letrës së instruksionit për bankën agjente italiane, duke informuar huamarrësin edhe për lëshimin e miratimin “nulla osta” nga ana e DPBZH-së.

B.3 Duke pasur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në pikën B.2, Mediocredito Centrale do t’i komunikojë huamarrësit, bankës agjente italiane dhe PMU-së përfshirjen e kontratave në Marrëveshjen financiare dhe përfshirjen e tyre në linjën e kredisë.

Kompletimi i kësaj procedure lejon kryerjen “e parapagimit” sipas procedurave të parashikuara në secilën kontratë dhe përcakton edhe datën e hyrjes në fuqi të saj.

B.4 Përsa i përket të gjitha pagesave të tjera, ato mund të bëhen vetëm pasi të jepet miratimi nga ana e PMU-së për kryerjen e të gjitha kërkesave të parashikuara në kontratë.

L I G J

Nr.9048, datë 7.4.2003

PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

Në mbështetje të neneve 59 pika 1 shkronja "g", 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim shpalljen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Objekt i këtij ligji janë vlerat e trashëgimisë kulturore, parashikimi i rregullave për mbrojtjen e saj dhe detyrat e përgjegjësitë e organeve që veprojnë në këtë fushë.

Neni 3

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ansambël arkitekturor” është tërësia e një numri ndërtesash, të cilat i lidh një koncept i njëjtë krijues.
2. “Ansambël historik” është bashkësia e vlerave urbanistiko-arkitektonike me vlera historike.
3. “Ansambël muzeal” është bashkësia e vlerave urbanistiko-arkitektonike që mbrohet nga shteti.
4. “Ansambël urban” është bashkësia e vlerave urbanistiko-arkitektonike me një qendër qytetare, e cila mund të formohet prej një ose disa pjesëve të një zone banimi.
5. “Ansambël urbanistik, arkitektonik, tradicional” është tërësia urbanistiko-arkitektonike e një qendre të banuar, e formuluar sipas kriterëve kompozicionale të së kaluarës.
6. “Arkitekturë tradicionale” është arkitektura e së kaluarës me zbatim kohor relativisht të gjerë.
7. “Dëmtim” është ndërhyrja në dëm të pasurisë kulturore, materiale ose jomateriale, që cenon funksionin ose pamjen origjinale të këtyre pasurive.
8. “Folklor gojor” është teksti i krijimit popullor, i pashoqëruar me muzikë, i cili lexohet ose tregohet.
9. “Folklor instrumental” është krijimi muzikor popullor i interpretuar me vegla muzikore popullore.
10. “Folklor koreografik” janë valle dhe krijime që kërcëhen me ose pa shoqërim muzikor.
11. “Folklor vokal” janë krijime muzikore të kënduara ose të interpretuara me tekst dhe muzikë.
12. “Institucione shtetërore të specializuara” janë Instituti i Monumenteve të Kulturës, Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Kulturës Popullore, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Arkivi i Filmit dhe Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike Kulturore.
13. “Inventarizim” është regjistrimi dhe identifikimi i objekteve të trashëgimisë kulturore.
14. “Katalogim informatik” është regjistrimi i të dhënave, sipas kriterëve të caktuara shkencore, për identifikimin dhe administrimin e shpejtë të pasurive kulturore.
15. “Mbrojtje” është mënyra dhe forma e natyrës juridike ose jo të ruajtjes, mirëmbajtjes, rindërtimit, restaurimit ose konservimit të pasurisë së trashëgimisë kulturore.
16. “Monument kulture” është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore që mbrohet nga shteti.
17. “Objekt në mbrojtje paraprake” është pasuria kulturore, materiale, në pritje për t’u shpallur monument kulture nga organi përgjegjës.
18. “Objekt nën vërtetim” është pasuria kulturore e pashpallur monument kulture, në shqyrtim për t’u përfshirë në mbrojtje nga shteti.
19. “Objekt unikal” është vepra arkitektonike me përdorim të zakonshëm ose me funksione artistike a zbukuruese dhe që, deri në çastin e dhënë, është identifikuar si e vetme në trashëgiminë kulturore e materiale.
20. “Park arkeologjik” është hapësira me vlera mjedisore, në të cilën ruhen rrënoja ndërtimore, të zbuluara prej gërmimeve arkeologjike që mbrohen nga shteti.

21. "Pasaporta e objektit" është kartela e identifikimit të një objekti të trashëgimisë kulturore, ku vendosen fotografia e objektit, filmimet, skicat, vendndodhja, përmasat, pesha, materiali, kodi kompjuterik, autori, vendi i ruajtjes, përshkrimi dhe historiku.

22. "Qendër arkeologjike" është hapësira ku ruhen mbi e nën tokë monumente dhe objekte me vlera arkeologjike.

23. "Qendër historike" është ansambli qytetar ose fshatar me vlera historiko-kulturore që mbrohet nga shteti.

24. "Qytet-muze" është qendra qytetare që mbrohet nga shteti për vlerat historiko-kulturore.

25. "Restaurim" është vlerësimi i thelbit origjinal të monumenteve nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme dhe nxjerrjes në pah të vlerave të tyre.

26. "Status i objektit" është gjendja juridike e një objekti.

27. "Trashëgimi me vlera kombëtare" është pasuria kulturore, materiale ose shpirtërore me vlera historiko-kulturore për kombin.

28. "Trashëgimi me vlera muzeale" është pasuria kulturore, materiale, e cila, për vlerat e veta historiko-kulturore ose artistike, meriton të ruhet në muze të profileve të ndryshme.

29. "Trashëgimi me vlera të veçanta" është pasuria kulturore, materiale ose shpirtërore me vlera të spikatura.

30. "Trashëgimi me vlera unike" është pasuria kulturore, materiale ose shpirtërore e vetme në llojin e vet.

31. "Vlerë arkeologjike" janë monumente, vendbanime historike të llojeve të ndryshme, objekte ose pjesë veprash ndërtimore apo vendbanimesh, të dalë prej gjurmëve arkeologjike, me vlera historiko-kulturore.

32. "Vlerë etnologjike" janë vlera të kulturës, materiale ose shpirtërore, të cilat lidhen me tiparet thelbësore të një kombi.

33. "Zeje tradicionale" është pjesa materiale dhe përvoja e përqendruar e mjeshtrave tanë popullorë në shekuj.

34. "Zonë arkeologjike" është sipërfaqja në të cilën gjenden monumente të zbuluara nga gjurmimet arkeologjike ose është dëshmuar qenia e shtresave me përmbajtje arkeologjike.

Neni 4

Trashëgimia kulturore përbëhet nga vlera materiale dhe jomateriale, të cilat janë pjesë e pasurisë kombëtare.

I. Vlerat materiale të trashëgimisë kulturore janë:

1. Objekte të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, ku përfshihen:

a) qendra, zona dhe rajone, të banuara ose të pabanuara, me vlerë arkeologjike, historike, etnologjike, arkitektonike dhe inxhinierike. Të tilla vlerësohen edhe objektet e kësaj natyre në gjendje rrënoje, me vjetërsi mbi 100-vjeçare;

b) ansamble urbane, arkitekturore dhe historike, ndërtime ose konstruksione ndërtimore me vlera të veçanta. Të tilla janë edhe objektet e kësaj natyre në gjendje rrënoje, me vjetërsi mbi 100-vjeçare.

2. Objekte të trashëgimisë kulturore të luajtshme, ku përfshihen:

a) objekte, pjesë ose elementë të objekteve, të përfshira në shkronjën "b" të pikës 1 të këtij neni, si mozaikë, kolona, kapitule, skulptura, piktura murale, ikona, ikonostase, tavane karakteristike, mbishkrime, gurë varresh, me vjetërsi mbi 100-vjeçare;

b) materiali i lëvizshëm arkeologjik, që del nga gjurmimet arkeologjike, grumbullohet nga gjurmimet arkeologjike, ose vjen si gjetje rastësore apo që ruhet në koleksione ose fonde të tjera të ndryshme;

c) krijimet artistike të të gjitha llojeve dhe gjinive. Këtu nuk përfshihen krijimet e autorëve të gjallë;

ç) dokumente arkivore me rëndësi historike kombëtare;

d) dorëshkrime dhe botime, libra dhe periodikë me vlera të veçanta, historike dhe bibliografike;

dh) koleksionet e ndryshme filatelike, numizmatike të artit, me vjetërsi mbi 25-vjeçare;

e) pajisje tradicionale pune, mjeshtërie dhe jetese. Mekanizma, makineri ose objekte të përdorimit të përditshëm ose atij ceremonial, me vlera artizanale, etnografike ose historike, objektet e prodhuara në mënyrë artizanale, me vjetërsi mbi 50-vjeçare dhe objektet e fabrikua me vjetërsi mbi 75- vjeçare;

ë) teknologji të prodhimit të produkteve të traditës;

f) armët e ftohta dhe të zjarrit, të prodhimit artizanal ose të fabrikua përpara fillimit të Luftës së Dytë Botërore;

g) objekte personale të figurave të shquara historike;

gj) objektet e përfshira në inventarët e pasurive, të shpallura në ruajtje ose në mbrojtje, të rrjetit muzeal e të galerive të [artit](#) dhe të institucioneve shtetërore të vendit deri në vitin 1991.

II. Vlerat jomateriale të trashëgimisë kulturore janë:

1. Përdorimi i gjuhës shqipe në veprat letrare.
2. Folklori gojor i ruajtur në kujtesë, i shkruar ose i regjistruar.
3. Folklori vokal, koreografik dhe instrumental.
4. Zakone dhe doke tradicionale.
5. Besime dhe bestytini të traditës.
6. Zejet e ndryshme tradicionale.

Neni 5

1. Vlerat materiale dhe jomateriale të trashëgimisë kulturore, që zbulohen ose krijohen, pavarësisht nga pronësia, mbrohen nga shteti.

2. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve shpall Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore.

Neni 6

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Akademia e Shkencave, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, universitetet, si dhe organet e qeverisjes vendore, sipas fushave përkatëse, bëjnë gjurmimin, mbrojtjen, konservimin, restaurimin, trajtimin, studimin, inventarizimin dhe katalogimin informatik të objekteve të trashëgimisë kulturore.

Neni 7

1. Instituti i Monumenteve të Kulturës, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Kulturës Popullore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, sipas kriterëve shkencorë, bëjnë përcaktimin e vlerave të objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme e të paluajtshme, të shpallura të tilla, pronë e çdo personi fizik ose juridik, si dhe dokumentimin e tyre.

2. Këto objekte, në mënyrë të detyrueshme, duhet të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore, e cila lëshon pasaportën e objektit në bazë të këtyre të dhënave.

3. Çdo ndryshim i pronësisë së objektit duhet të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

Neni 8

Çdo person fizik ose juridik është i detyruar të ruajë, sipas kriterëve të caktuara në këtë ligj dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, tërësinë e vlerave të trashëgimisë kulturore e historike që zotëron ose merr në përdorim.

Neni 9

1. Objektet e trashëgimisë kulturore me vlera të veçanta kombëtare dhe unike, që nuk janë në pronësi shtetërore, mund të koleksionohen, shiten, blihen, lihen trashëgim ose dhurohen ndërmjet shtetasve shqiptarë që jetojnë brenda vendit.

2. Shteti shqiptar gëzon të drejtën e parablerjes së objekteve me vlera të veçanta kombëtare

dhe unike të trashëgimisë kulturore, që ndodhen në pronësi private.

3. Çdo pronar që dëshiron të shesë një objekt të trashëgimisë kulturore, është i detyruar të paraqesë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve pasaportën e objektit. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, pas këshillimit me organet e specializuara sipas fushave përkatëse, i kthen përgjigje pronarit të objektit brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës. Nëse Ministria është e interesuar për blerjen e këtij objekti, fillon procedurën e vlerësimit. Në rast të kundërt, pronari ka të drejtë të bëjë shitjen, duke i bashkëlidhur dokumentacionit të objektit mendimin me shkrim të institucionit që ka bërë vlerësimin e tij.

4. Për vlerësimin e objekteve në pronësi private të trashëgimisë kulturore të luajtshme, që nxirren jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ngrihet një komision i përhershëm me ekspertë nga institucionet e specializuara shkencore, i cili, në përfundim të vlerësimit të objekteve, i rekomandon Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve lëshimin ose jo të autorizimit për nxjerrjen e këtyre objekteve jashtë territorit të vendit.

5. Funksionimi i komisionit, procedurat e vlerësimit dhe kriteret shkencore, përzgjedhja e anëtarëve dhe shpërblymimi i tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

1. Zhvendosja e vlerave të trashëgimisë kulturore, për ruajtjen e vlerave të tyre në mjedise të përshtatshme, nga pikëpamja e sigurisë ose e mikroklimës, në varësi të natyrës së objektit, bëhet nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Kulturës Popullore ose Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit.

2. Zhvendosja realizohet pasi këto institucione të kenë përgatitur dokumentacionin dhe studimet përkatëse dhe të kenë bërë regjistrimin e zhvendosjes në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

Neni 11

Shumëfishimi dhe riprodhimi i certifikuar i objekteve të trashëgimisë kulturore bëhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për të drejtën e autorit, pasi është marrë leja e Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

Neni 12

Objektet e trashëgimisë kulturore në pronësi private, me vlera të veçanta kombëtare dhe unike, kur e kërkon interesi publik, mund të shpronësohen në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi për shpronësimet.

Neni 13

Personat fizikë ose juridikë që kanë në pronësi objekte të regjistruara me vlera të trashëgimisë kulturore, të luajtshme e të paluajtshme, janë të detyruar të krijojnë kushte mirëmbajtjeje për këto objekte. Për restaurimin e këtyre objekteve ata janë të detyruar t'i drejtohen Institutit të Monumenteve të Kulturës, Institutit të Arkeologjisë, Institutit të Kulturës Popullore ose subjekteve të licensuara sipas nenit 17 pika 3.

Neni 14

Në rastin e fatkeqësive natyrore, të shembjes ose të djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, kur nuk vendoset kryerja e rikonstruksionit, mbi truallin e mbetur ose mbi pasurinë rrënojë, lejohet ndërtimi vetëm në sipërfaqen dhe vëllimin e mëparshëm, duke respektuar kategorinë dhe llojin e monumentit të dëmtuar.

Neni 15

1. Instituti i Monumenteve të Kulturës, Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Kulturës Popullore ose Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, me leje të pronarit dhe në prani të tij, kanë të drejtë të kontrollojnë gjendjen fizike të objektit ose të objekteve në pronësi private.

2. Pronarët e çdo objekti, pas kërkesës së bërë nga institucionet e mësipërme, janë të detyruar të lejojnë kontrollin e gjendjes fizike të objektit.

Neni 16

1. Institucionet e specializuara shtetërore, në marrëveshje me pronarët dhe zotëruesit e objekteve të trashëgimisë kulturore, krijojnë kushte për ekspozimin e këtyre objekteve për publikun.

2. Fotografimi, filmimi ose regjistrimi kompjuterik dhe publikimi i objekteve të trashëgimisë kulturore, të ekspozuara në muzetë vendorë, bëhet pasi të jetë marrë leje nga institucioni shtetëror, në varësi të të cilit është muzeu. Për objekte të tilla, të ekspozuara në muzetë kombëtarë, leja miratohet nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 17

1. Restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore bëhet nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga personat fizikë ose juridikë të licensuar për këtë qëllim.

2. Personat fizikë ose juridikë, kandidatë për marrjen e licencës së ushtrimit të profesionit të restauratorit në fushën e trashëgimisë kulturore, testohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

3. Këshilli Kombëtar i Restaurimeve ngrihet me urdhër të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe ka në përbërje përfaqësues të institucioneve të specializuara dhe personalitete të fushës përkatëse. Organizimi dhe funksionimi i këtij Këshilli përcaktohet në rregulloren e miratuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

4. Leja e ushtrimit të profesionit në këtë fushë miratohet nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

5. Punimet e restaurimit, të cilat kryhen nga organizma jashtë sistemit të institucioneve shtetërore, të ngarkuara për mbrojtjen, konservimin, restaurimin e studimin, mbikëqyrën detyrimisht nga këto institucione.

6. Projektet e restaurimit në çdo rast miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

Neni 18

Fondet për mirëmbajtjen, restaurimin, zbulimin dhe studimin e vlerave të trashëgimisë kulturore sigurohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, nga të ardhurat e përdorimit të tyre, si dhe nga çdo e ardhur tjetër e ligjshme, që sigurohet nga fondacione, organizata dhe institucione, vendase ose të huaja, shtetërore ose private apo nga personat fizikë ose juridikë.

Fondet e siguruara nga përdorimi i monumenteve të kulturës vihen tërësisht në dispozicion të restaurimit e mirëmbajtjes së tyre.

KREU II TRASHËGIMIA KULTURORE E LUAJTSHME

Neni 19

1. Lëvizja nga vendet e caktuara të objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, në pronësi shtetërore, me vlera të zakonshme ose të veçanta, kombëtare dhe unikale, për ruajtjen, restaurimin, studimin, ekspozimin brenda vendit ose tjetërsimin e pronësisë, bëhet me lejen e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Lëvizja nga vendet e caktuara të objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të zakonshme, për ruajtjen, restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet me lejen e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Lëvizja e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta, kombëtare

dhe unike për ruajtjen, restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave. Procedurat e këtyre lëvizjeve përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave, sipas konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë për këtë qëllim.

4. Në çdo rast, leja e lëshuar regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

Neni 20

1. Objektet e trashëgimisë kulturore të veçantë, kombëtare dhe unike, nuk dhurohen e nuk shkëmbehen në asnjë rast.

2. Në raste të veçanta, objektet e trashëgimisë kulturore të luajtshme mund të dhurohen ose shkëmbehen ndërmjet institucioneve simotra në shtete të tjera, kur u shërbejnë interesave kombëtarë dhe janë të barazvlefshme. Dhurimi ose shkëmbimi bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21

1. Shteti shqiptar bëhet menjëherë pronar i ligjshëm i objekteve të trashëgimisë kulturore, të cilat nuk janë në pronësi shtetërore, por që janë të vjedhura ose të humbura, nëse pronari i tyre nuk identifikohet.

2. Shteti shqiptar bëhet menjëherë pronar i ligjshëm i objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, të cilat nuk janë në pronësi shtetërore, të nxjerra në mënyrë të jashtëligjshme jashtë vendit.

Neni 22

Objektet e trashëgimisë kulturore të luajtshme, arkivat dhe koleksionet e institucioneve shtetërore e joshetërore, si dhe ato të ekspozuara në muzetë kombëtarë ose vendorë, shtetërorë ose joshetërorë, mbrohen dhe administrohen sipas rregulloreve të vetë institucioneve, të cilat hartohen në përputhje me këtë ligj, si dhe me legjislacionin për arkivat.

Neni 23

Në rastet kur godinat, ku ruhen arkiva shtetërore ose vlera të tjera të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, u kthehen ish-pronarëve dhe shpronësimi është i pamundur, Këshilli i Ministrave bën sistemimin në mjedise të tjera të përshtatshme të këtyre institucioneve.

KREU III TRASHËGIMIA KULTURORE E PALUAJTSHME

Neni 24

1. Objekti i trashëgimisë kulturore ka këto shkallë mbrojtjeje:

- a) nën vërtim;
- b) në mbrojtje paraprake;
- c) monument kulture të kategorisë II ;
- ç) monument kulture të kategorisë I.

2. Objektet në grup emërtohen sipas rastit: park arkeologjik, qytet-muze, zonë-muze, qendër historike, qendër arkeologjike dhe ansambël-muze.

3. Heqja e plotë ose e pjesshme e mbrojtjes nga shteti e një objekti ose grupi objektiv të trashëgimisë kulturore është e drejtë ekskluzive e organit që e ka shpallur atë.

Neni 25

1. Objekte nën vërtim janë të gjitha objektet në gjendje rrënoje, kështjella, objekte kult, ndërtime inxhinierike, ndërtime publike ose të luksit, të ndërtuara përpara vitit 1900 dhe ato në

shfrytëzim, të ndërtuara përpara vitit 1944. Ky status shpallet nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe është i përhershëm.

2. Ndryshimi ose heqja e këtij statusi bëhet me kërkesë të pronarit të objektit drejtuar Institutit të Monumenteve të Kulturës.

3. Objekti me këtë status nuk mund të priset ose t'i bëhen [ndryshime, pa](#) miratimin me shkrim të Institutit të Monumenteve të Kulturës.

Neni 26

1. Objekt në mbrojtje paraprake shpallet nga Instituti i Monumenteve të Kulturës çdo objekt me vlera të veçanta. Ky status është 6-mujor dhe brenda kësaj periudhe ky institucion duhet të kryejë procedurat për përcaktimin e statusit të mëtejshëm të tij.

2. Gjatë kësaj periudhe ndalohet çdo lloj ndërhyrje në gjendjen fizike të objektit.

Neni 27

Monumente kulture të kategorisë II janë të gjitha ndërtimet në zonat-muze dhe në ato zona të mbrojtura të qyteteve-muze në qendrat historike, të pacilësuar monumente të kategorisë I. Ato ruhen vetëm në vëllime dhe përbërje arkitektonike të pamjeve të tyre të jashtme. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i shpall ato monumente kulture të kategorisë II.

Neni 28

1. Monumente Kulture të kategorisë I janë ndërtimet me vlera të spikatura dhe me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore. Ato ruhen në tërësinë e përbërësve të tyre arkitektonikë dhe teknikë.

2. Kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme dhe të [brendshme, si](#) dhe zgjidhja planimetrike dhe funksionale e këtyre monumenteve nuk mund të ndryshohen.

3. Ndërtimet e reja pranë tyre duhet të respektojnë distancat e zonës së mbrojtur.

4. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i shpall ato monumente kulture të kategorisë I.

Neni 29

1. Qytetet-muze, zonat-muze, qendrat historike, ansamblet-muze, qendrat dhe parqet arkeologjike janë kategori objektesh në grup, që ruhen në tërësinë e tyre si komplekse historiko-arkeologjike, monumentale, arkitektoniko-urbanistike dhe mjedisore dhe për këtë ndalohen ndërtimet e reja që prekin objektet ekzistuese, me përjashtim të rjetit inxhinierik nëntokësor.

2. Rregullorja e administrimit për kategoritë e objekteve të mësipërme miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Monumentet e kulturës të kategorisë I dhe II në qendrat historike, qytetet-muze dhe ansamblet-muze mund të shfrytëzohen edhe për funksione të tjera, që nuk cenojnë në asnjë mënyrë vlerat e tyre. Aty mund të vendosen institucione shtetërore ose [private, si](#) muze, biblioteka, atelie monumentesh, fototeka, galeri artesh dhe ekspozita të ndryshme.

Neni 30

Institucionet e specializuara të fushave të trashëgimisë kulturore, organet e qeverisjes vendore dhe pronarët ose përdoruesit e objektit kanë të drejtën e propozimit për shpalljen e një objekti monument kulture. Propozimi i drejtohet Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 31

1. Qytetet-muze, zonat-muze, zonat arkeologjike, qendrat historike, ansamblet-muze dhe parqet arkeologjike shpallen të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave pas propozimit të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Heqja e plotë ose e pjesshme e shkallës së mbrojtjes në monumentet e kulturës bëhet me vendim të po atij organi, që e ka vendosur atë.

Neni 32

1. Për monumentet e kulturës përcaktohet një sipërfaqe toke ose trualli përreth, si zonë mbrojtëse, në përputhje me vlerat e tyre arkitektonike, me përshtatshmërinë e tyre urbanistiko-estetike, me rrethinën dhe me rrethanat ekologjike.

2. Përmasat e zonës mbrojtëse përcaktohen nga organi që shpall monumentin, sipas studimit të bërë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Neni 33

1. Gërmimi, restaurimi, përdorimi dhe çdo veprim tjetër në monumentet e kulturës, si dhe çdo ndryshim në truallin e vënë në mbrojtje rreth tyre, bëhet vetëm me autorizimin e Institutit të Arkeologjisë ose të Institutit të Monumenteve të Kulturës.

2. Ndalohet gërmimi me karakter arkeologjik dhe përdorimi i aparaturave metalkërkuese nga njerëz ose subjekte të paautorizuara.

Neni 34

Njësitë e qeverisjes vendore bashkëpunojnë me Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe Institutin e Arkeologjisë për ruajtjen dhe mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore, që ndodhen në territoret në juridiksionin e tyre. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve përcakton mënyrat e bashkëpunimit.

Neni 35

Punimet e mirëmbajtjes, të restaurimit dhe të rigjallërimit të monumenteve të kulturës kryhen me fondet e dhëna Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nga Buxheti i Shtetit, pasi të jetë miratuar plani i këtyre punimeve nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Neni 36

1. Në monumentet e kulturës të kategorive I dhe II, pronë e subjekteve joshтетërore, shteti përballon të gjitha shpenzimet për ruajtjen e vlerave historiko-artistike, të cilat nuk lidhen me qëndrueshmërinë e objektit.

2. Punimet e tjera të restaurimit për këto monumente përballohen në masën:

a) 50 për qind nga shteti dhe 50 për qind nga pronari për monumentet e kulturës të kategorisë I;

b) 30 për qind nga shteti dhe 70 për qind nga pronari për monumentet e kulturës të kategorisë II.

Neni 37

1. Kur pronari joshтетëror i monumentit të kulturës nuk ka fonde për kryerjen e punimeve të restaurimit, pas planifikimit të këtyre punimeve, shteti ndërmjetëson pranë bankave për përfitimin e kredive afatgjata me kushte lehtësuese.

2. Kur pronari kundërshton kredinë dhe kur monumenti është në rrezik shembje, punimet e restaurimit bëhen edhe pa pëlqimin e tij nga Instituti i Monumenteve të Kulturës ose edhe nga subjekte të tjera të licencuara për këtë qëllim. Pas përfundimit të punimeve, pronari detyrohet të paguajë pjesën e vet të shpenzimeve, në përputhje me nenin 36 të këtij ligji.

Neni 38

Çdo vendim i marrë nga këshillat e rregullimit të territoreve për ndërhyrje ose ndërtim në zonat e shpallura monument kulture ose në zonën e mbrojtur pranë një monumenti kulture, pavarësisht nga pronësia, është i pavlefshëm.

Neni 39

1. Monumentet e kulturës mund të rrijtëzohen për qëllime administrative dhe socialkulturore, me kusht që funksioni i ri të mos dëmtojë vlerën e monumentit.

2. Në çdo rast, shfrytëzimi i monumenteve të kulturës lejohet vetëm pasi të jetë lidhur kontrata ndërmjet përdoruesit dhe pronarit, i cili është i detyruar të vërë në dijeni Institutin e Monumenteve të Kulturës.

Neni 40

1. Vendosja e materialeve publicitare në objektet monument kulture bëhet në raste të veçanta festivo-kulturore dhe ka karakter të përkohshëm.

2. Veprimtaritë kulturore në objektet monument kulture bëhen vetëm në rastet kur ato nuk rrezikojnë ose cenojnë vlerat e tyre.

3. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve jep lejen për organizimin e veprimtarive kulturore dhe vendosjen e materialeve publicitare.

Neni 41

Kërkimet, sondazhet dhe gërmimet arkeologjike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë monopol i shtetit shqiptar.

Neni 42

1. Veprimtaritë e përshkruara në nenin 41 realizohen nga Instituti i Arkeologjisë.

2. Këto veprimtari kryhen në bazë të bashkërendimit të punëve ndërmjet Institutit të Arkeologjisë dhe Institutit të Monumenteve të Kulturës.

3. Për realizimin e këtyre veprimeve mund të bashkëpunohet edhe me institucione të tjera të specializuara, shtetërore ose private, vendase ose të huaja. Këto bashkëpunime bëhen në bazë të marrëveshjeve ose kontratave dy ose shumëpalëshe. Përfshihet ekskluziviteti i institucioneve të huaja. Për bashkëpunimin, në çdo rast, merret miratimi nga organi më i lartë.

Neni 43

1. Qendrat, zonat dhe parqet arkeologjike përcaktohen nga Instituti i Arkeologjisë dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës. Në territoret, që hyjnë në këtë grup, është e ndaluar çdo lloj ndërhyrjeje me karakter ndërtimor ose veprimtari të tjera që i dëmtojnë ato.

2. Zonat arkeologjike në studim përcaktohen nga Instituti i Arkeologjisë dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës. Çdo ndërhyrje në këto zona kryhet në prani të specialistëve të këtyre institucioneve.

Neni 44

Objektet arkeologjike, të gjetura gjatë gërmimeve arkeologjike, janë pronë e shtetit shqiptar.

Neni 45

Personat fizikë ose juridikë, që zbulojnë ose gjejnë, në mënyrë të rastësishme, objekte të trashëgimisë kulturore, janë të detyruar që brenda 20 ditëve të njoftojnë organet vendore të kulturës, Institutin e Arkeologjisë dhe Institutin e Monumenteve të Kulturës, duke deklaruar mënyrën dhe vendin e gjetjes. Pas dokumentimit të objektit, komisioni i ngritur për këtë qëllim me specialistë të

këtyre institucioneve përcakton vlerat dhe vendos për statusin e mëtejshëm të [objektit, si](#) dhe shpërblimin e këtij personi.

Neni 46

Për ndjekjen e gjetjeve rastësore arkeologjike, që dalin gjatë punimeve bujqësore, ndërtimit të veprave inxhinierike ose konstruksioneve ndërtimore dhe marrjen e masave të shpëtimit të këtyre vlerave, në rastet kur ato nuk përballohen nga strukturat e Institutit të Arkeologjisë ose të Institutit të Monumenteve të Kulturës, organizohen struktura të veçanta, të përkohshme, me urdhër të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 47

Në rastet e ndërtimeve të mëdha në territore në pronësi shtetërore ose private, si rrugë, autostrada, aeroporte, porte, vepra industriale, qendra të reja banimi, investitorët janë të detyruar që, gjatë procesit të projektimit dhe zbatimit të projektit, të këshillohen me specialistë të Institutit të Arkeologjisë dhe Institutit të Monumenteve të Kulturës. Specialistët kryejnë kontrollin e zonës dhe përgatisin dokumentacionin përkatës. Kur zona përmban vlera të rëndësishme arkeologjike, etnografike ose gjurmë të arkitekturës së lashtë ose tradicionale, projekti duhet të ndryshojë. Propozimi për ndryshime bëhet nga institucionet që kanë kryer kontrollin dhe shpenzimet për këto ndryshime përballohen nga investitori.

Neni 48

1. Kur, pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë.

Drejtuesit dhe investitorët e punimeve njoftojnë, brenda tri ditëve, organet e qeverisjes vendore, Institutin e Arkeologjisë dhe Institutin e Monumenteve të Kulturës, të cilët bëjnë kontrollin përkatës, raportojnë për vlerat e gjetura dhe bëjnë propozimet përkatëse për vazhdimësinë ose jo të punimeve.

2. Nëse gjetjet janë me vlera të rëndësishme, punimet e filluara mund të pësojnë ndryshime ose të ndërpriten përfundimisht. Vendimi në këtë rast merret nga organi që ka autorizuar fillimin e punimeve.

3. Në rastin kur punimet pësojnë ndryshime, të gjitha shpenzimet për to, si dhe shpenzimet për kërkimet shkencore, veprimtaritë e nevojshme restauruese ose konservuese, mbulohen 100 për qind nga investitori.

KREU IV KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 49

1. Janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e mëposhtme:

- a) shkeljet sipas nenit 7 dënohen me gjobë nga 10 000 -20 000 lekë;
- b) shkeljet sipas nenit 8 dënohen me gjobë nga 30 000 - 50 000 lekë;
- c) shkeljet sipas neneve 11 dhe 19 dënohen me gjobë nga 20 000 - 50 000 lekë;
- ç) shkeljet sipas nenit 14 dënohen me gjobë nga 100 000 - 500 000 lekë;
- d) shkeljet sipas nenit 16 pika 2 dënohen me gjobë 20 000 lekë;
- dh) shkeljet sipas neneve 25 pika 3 dhe 26 pika 2 dënohen me gjobë nga 100 000 - 300 000 lekë;
- e) shkeljet sipas nenit 28 pika 2 dënohen me gjobë nga 100 000 - 500 000 lekë;
- ë) shkeljet sipas nenit 33 pika 1 dënohen me gjobë nga 50 000 -500 000 lekë;
- f) shkeljet sipas nenit 45 dënohen me gjobë nga 10 000 - 50 000 lekë;
- g) shkeljet sipas nenit 33 pika 2 dënohen me gjobë 100 000 lekë dhe konfiskim të aparaturës;

gj) shkeljet sipas neneve 47 dhe 48 pika 1 dënohen me gjobë nga 000 - 5 000 000 lekë.

1 000

2. Dëmi i shkaktuar në objektet unike të trashëgimisë kulturore përbën në çdo rast veprë penale dhe dënohet sipas legjislacionit penal.

Neni 50

1. Të drejtën e vënies së gjobës e kanë inspektorët e Institutit të Arkeologjisë, Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore, sipas fushave që mbulojnë.

2. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhen sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

3. Shuma e arkëtuar nga vjelja e gjobave derdhet 50 përqind në favor të Buxhetit të Shtetit dhe 50 përqind në favor të institucionit që e ka objektin nën juridiksion.

KREU V DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 51

Çdo person fizik ose juridik, që zotëron objekte, të cilat janë vlera të trashëgimisë kulturore të luajtshme, duhet t'i deklarojë ato pranë organeve të kulturës, të qeverisjes vendore dhe ta regjistrojë objektin në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore, sipas mënyrës që ofron kjo qendër, brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 52

Për objektet monument kulture të dhëna me qira përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, kontrata e qiramarrjes, për periudhën e mbetur, rregullohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 53

1. Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Instituti i Arkeologjisë, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i paraqesin për miratim Këshillit të Ministrave zonat arkeologjike brenda qendrave të banuara në Shkodër, Lezhë, Krujë, Durrës, Elbasan, Berat, Vlorë dhe Sarandë.

2. Brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Instituti i Arkeologjisë i paraqesin për miratim Këshillit të Ministrave kufijtë dhe rregulloret e administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikut, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit.

3. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, institucionet e specializuara në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, statutet e të cilave miratohen nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, bëjnë rishikimin e këtyre statuteve, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 54

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të neneve 9 pika 5, 19 pika 3, 20 pika 2, 23, 29 pika 2 dhe 31 pika 1, të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 55

Ligji nr.7867, datë 12.10.1994 "Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme", shfuqizohet.

Neni 56

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3804, datë 5.5.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

D E K R E T
Nr.3809, datë 8.5.2003

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës të neneve 24 dhe 19 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U rijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|----------------------------------|--------------------------------------|
| 1. Afërdita Hasan Xhemali (Pajo) | 27. Elida Eshref Trimaçi |
| 2. Gjystina Tonin Rangu | 28. Merita Eshref Trimaçi |
| 3. Polikseni Kristo Rapo | 29. Gëzim Eshref Trimaçi |
| 4. Artur Petro Rapo | 30. Egis Gëzim Trimaçi |
| 5. Kristaq Sotir Piperi | 31. Esmeralda Piro Trimaçi (Gjerazi) |
| 6. Natasha Vasil Piperi | 32. Semi Sadi Pashallari |
| 7. Elena Kristaq Piperi | 33. Kemal Semi Pashallari |
| 8. Dhimitraq Kristaq Piperi | 34. Sadi Kemal Pashallari |
| 9. Postol Vasil Piperi | 35. Aili Kemal Pashallari |
| 10. Djana Sotir Piperi | 36. Nargis Bexhet Pashallari (Shehu) |
| 11. Zurika Postol Piperi | 37. Spiro Thanasi Gurmo |
| 12. Vangjush Postol Piperi | 38. Thanasi Spiro Gurmo |
| 13. Anesti Postol Piperi | 39. Dorela Spiro Gurmo |
| 14. Alma Ilia Emanuil | 40. Lindita Fillo Gurmo (Ciko) |
| 15. Llazaraq Janaq Caca | 41. Thoma Epaminonda Pulia |
| 16. Gentiana Llazaraq Caca | 42. Katerina Thimaq Pulia |
| 17. Ilirian Llazaraq Caca | 43. Stelina Thoma Pulia |
| 18. Vangjel Janaq Caca | 44. Xhemal Hysen Rahova |
| 19. Ervis Vangjel Caca | 45. Sabahete Smajl Rahova |
| 20. Lena Pilo Caca | 46. Nexhmije Xhemal Rahova |
| 21. Sofiela Vangjel Caca | 47. Ritvan Xhemal Rahova |
| 22. Majlinda Mustafa Myrtollari | 48. Ylber Xhemal Rahova |
| 23. Maristeva Vaso Drinjak | 49. Suela Vladimir Gorenca |
| 24. Urani Spiro Konda | 50. Hysen Ismail Pirgu |
| 25. Vasil Piro Maliko | 51. Ismihan Semi Pirgu (Pashallari) |
| 26. Vehbie Muhamet Trimaçi | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 16.5.2003

Doli nga shtypi më 16.5.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë